



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/263
Datë: 8 / 11 / 2017

NJOFTIM

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në mbledhjen e mbajtur me datë 5.10.2017 mori vendim për publikim të njoftimit për aplikim për lirim nga pagesa e semestrave për studentët e UP-së që i takojnë kategorisë si në vijim:

1. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në Universitetin e Prishtinës do të paguajnë vetëm për një student, ndërsa për studentë tjerë nuk do të paguajnë, (lirohen vetëm studentët në nivelin bachelor dhe master sipas kushteve të specifikuara në vijim).

Përfitimi nga lirimi i pagesës sipas prioriteteve

Kur një familje kosovare ka më shumë se një studentë në Universitetin e Prishtinës, lirimi nga pagesa për studentë do të bëhet sipas këtij prioriteti:

1. Studentët me statusin e studentit të rregullt në nivelin bachelor¹;
2. Studentët me statusin e studentit me korrespondencë në nivelin bachelor²;
3. Studentët me statusin e studentit të rregullt në nivelin master³.

Kufizimi i të drejtë së përfitimit nga lirimi i pagesës

Nuk do të përfitojnë nga lirimi prej pagesës studentët të cilët kanë të përsëritur së paku një herë vitin akademik gjatë kohës së studimeve si dhe studentët e nivelit të doktoratës. Dokumentacioni i studentëve që kanë të përsëritur një herë e më shumë vitin akademik, nuk do të merret në konsideratë për lirim të kandidatëve tjerë të familjes.⁴

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- a. Certifikata e lindjes për secilin prej studentëve të familjes së ngushtë;
- b. Certifikatën e bashkësisë familjare;
- c. Kopja e letërnjoftimit të studentit/es;
- d. Vërtetimin për statusin e studentit, dhe dëshminë për regjistrim të vitit akademik aktual, (secili student veç e veç);

¹ Prioritet të parë për lirim do të kenë studentët me status të rregullt në nivelin bachelor në raport me studentin që ka status me korrespondencë në nivelin bachelor dhe me studentin e nivelit master;

² Prioritet të dytë për lirim do të kenë studentët që kanë statusin e studentit me korrespondencë në nivelin bachelor në raport me studentin e nivelit master.

³ Studenti i nivelit master mund të lirohet vetëm nëse nuk ka studentë që i takojnë dy prioriteteve paraprake.

⁴ Nëse në UP studiojnë 3 anëtarë të një familje të ngushtë, dy nga të cilët kanë të përsëritur njëherë apo më shumë një vit akademik, atëherë anëtari i tretë që nuk është përsëritës do të refuzohet sepse nuk konsiderohet se kjo familje i ka tre studentë të cilët potencialisht secili prej tyre do të ishte kandidatë që i plotëson kushtet për lirim.

- e. Dëshmia nga njësia akademike që studenti nuk ka asnjë vit të përsëritur që nga regjistrimi i studimeve në fakultet;
- f. Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje (pa i caktuar studenti prioritetet), numrin kontaktues dhe e-mail adresën e secilit studentë.

Dokumentacioni i kompletuar për lirim nga pagesa në emër të të gjithë studentëve të së njëjtës familje dorëzohen në zyrën e shërbimit të studentëve në ndërtesën e Bibliotekës Qendrore të Universitetit, ndërsa komisioni vendos se cili prej studentëve do lirohet nga pagesa.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni për lirim.

Studentët të cilët lirohen nga pagesa do të informohen përmes fakultetit në të cilin kanë aplikuar dhe ueb-faqes elektronike të UP-së www.uni-pr.edu

Afati i paraqitjes së dokumenteve është 10 ditë nga dita e publikimit të njoftimit, përkatësisht nga data 08.11.2017 deri më 17.11.2017 në ora 15.00.

Studentët përfitues të së drejtës për lirim nga pagesa duhet të parashtrajnë kërkesë pranë njësisë akademike përkatëse, për rimbursim të mjeteve të paguara për regjistrim të semestrave përkatës të vitit akademik, duke bashkëlidhur dokumentet si në vijim:

-Fletëpagesën e semestrit;

-Kopjen e letërnjoftimit ose ID- kartelës studentore ose indeksit dhe

-Kopjen e kartelës së bankës (nr. i xhirlogarisë të jetë i qartë).

Këshillë juridike: Studentët e pakënaqur me vendim të komisionit për lirim nga pagesa, mund të bëjnë ankesë pranë të njëjtit komision, në ndërtesën e rektoratit në afat prej 48 orësh pas publikimit të vendimit të komisionit për lirim nga pagesa.

Kushtet e përcaktuara me këtë njoftim do të vlejnjë edhe për vitet vijuese deri në marrjen e një vendimi tjetër nga Këshilli Drejtues i UP-së.

